



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12,14 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 10 paragrafi 1 pika 1.4 të Ligjit për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.04/L-144 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës e datës 22 nëntor 2012, nenit 20 paragrafi 3 pika 3.3 të Rregullores QRK Nr.23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës, dhe nenit 9,17,20 të Statutit të Komunës së Lipjanit INr.110-623 të dt.26.09.2008, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur 28. 02. 2019, pas shqyrtimit të propozimit të vendimit të Kryetarit të Komunës miratoi këtë:

VENDIM

PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS KOMUNALE KËSHILLIT TË BASHKËSISË ISLAME NË LIPJAN PËR NDËRTIMIN E XHAMISË NË FSHATIN GRACKË E VOGËL

Neni 1

Me këtë vendim ipet në shfrytëzim afatgjatë prej 99 vitesh prona komunale me sipërfaqe prej 1000m² (10 ari) Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan për ndërtimin e xhamisë për nevojat e banorëve në fshatin Grackë e Vogël, nga parcela kadastrale P-71409051-00106-1 në vendin e quajtur "Kod Groblja" me kulturë kullosë e klasit 2-të zona kadastrale Grackë e Vogël, Kuvendi Komunal Lipjan.

Neni 2

Me këtë Vendim obligohet Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër që të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme në lidhje me procedurën e regjistrimit të parcelës 00106-1 me sipërfaqe prej 1000m² KK Lipjan shfrytëzues Këshilli i Bashkësisë Islame në Lipjan, siç përcaktohet në nenin 1 të këtij Vendimi.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit-Sektorit pronëso- juridik, Drejtorati për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

15Nr. 463-14829
Lipjan, më 04. 03. 2019

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

